



**Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara
nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut**

**PROCEDURAT DHE KRITERET PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE SHETASVE
TË KOSOVËS TË CILËT KANË MARRË DIPLOMA NGA UNIVERSITETI I
MITROVICËS SË VERIUT, PËR QËLLIM TË APLIKIMIT PËR
VENDE PUNE DHE PËR MARRJEN E LICENCAVE DHE PROVIMEVE
PROFESIONALE NË INSTITUCIONET PUBLIKE**



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar
nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë



ME ÇKA JANË PËRCAKTUAR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE TË VLEFSHMËRISË SË NJË PERSONI QË KA DIPLOMUAR NË UNIVERSITETIN E MITROVICËS SË VERIUT

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30.12.2015 ka miratuar në Rregulloren (QRK) - Nr.21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave dhe kriterëve për lëshimin e certifikatave të vlefshmërisë për shtetasit e Kosovës që kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut (UMV).

Këtë rregullore mund ta gjeni në:



[http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_\(QRK\)_-_NR__212015_PER_PROCEDURAT_DHE_KRITERET_PER_LESHIMIN_E_CERTIFIKATAVE_SHTETASVE_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_TE_CILET_KANE_MARR.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_(QRK)_-_NR__212015_PER_PROCEDURAT_DHE_KRITERET_PER_LESHIMIN_E_CERTIFIKATAVE_SHTETASVE_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_TE_CILET_KANE_MARR.pdf)



PËR ÇKA NEVOJITEN CERTIFIKATAT E VLEFSHMËRISË

Certifikata e vlefshmërisë shërben dhe mund të përdoret për të aplikuar për punësim në të gjitha institucionet publike të Kosovës, për marrjen e licencave nga institucionet publike të Kosovës, dhe për pjesëmarrje në provime profesionale të organizuar nga institucionet publike të Kosovës.

Lëshimi i certifikatave dhe përdorimi i tyre si zëvendësim i diplomave të UMV-së është masë e përkohshme afirmative për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të shtetasve të Kosovës, për të mundësuar qasje të barabartë në punësim për të gjithë shtetasit e Kosovës, me qëllim të realizimit të përfaqësimit të barabartë të të gjitha grupeve të popullsisë në punësim në institucionet e sektorit publik.



KUSH I LËSHON CERTIFIKATAT E VLEFSHMËRISË

Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, është emëruar nga Qeveria me Vendimin Nr. 08/73, të Datës: 05.02.2016.

Komisioni është multietnik dhe përbëhet prej katër (4) anëtarëve: Dy (2) anëtar të propozuar nga Kryeministri, dhe dy (2) anëtar të propozuar nga ministri i MASHT-it. Komisioni është përgjegjës për lëshimin e certifikatave për qytetarët e Kosovës, të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut.

Komisioni Shqyrton kërkesat e shtetasve të Kosovës, që kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut, Lëshon Certifikatat për personat që i përmbushin kriteret për marrjen e certifikatave dhe mban regjistrin për të gjitha lëndët e shqyrtuara.

Këtë Vendim mund ta gjeni në:



[http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_73-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2016_\(3\).pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_73-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2016_(3).pdf)



SEKRETARIA E KOMISIONIT

Në pajtim me Nenin 19 (Sekretaria e Komisionit), të Rregullores (QRK) - Nr.21/2015, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me Vendimin e datës 15 qershor 2016 (Ref.Nr. 122/01B) ka emëruar anëtarët e Sekretarisë së Komisionit. Detyrat e Sekretarisë janë ofrimi dhe mbështetja administrative e Komisionit, sipas përshkrimit të punëve të përcaktuara nga Komisioni. Anëtarët e Sekretarisë i përgjigjen Kryetarit të Komisionit. Të gjitha njësitë e MASHT-it dhe të Qeverisë janë të obliguar t'i ofrojnë asistencë Komisionit dhe Sekretarisë, për realizimin e mandatit të tyre.



AUTORIZIMI NGA QEVERIA I OJQ-SË ECMI-KOSOVA

Në pajtim me Nenin 21 (OJQ-ja e autorizuar), të Rregullores (QRK) - Nr.21/2015, me propozimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, OJQ ECMI-Kosova, është e autorizuar nga Qeveria, me Vendimin nr. 11/81 të datës 23.03.2016, për mbështetjen e punës së Komisionit.

MASHT, me qëllim të lehtësimit të kontakteve me UVM-në, verifikimit të dokumentacionit mbështetës, dhe përmirësimit të qasjes për dorëzimin e aplikacioneve, mbështetjes administrative të Komisionit-Sekretarisë, lidhë memorandum mirëkuptimi me ECMI Kosova, i cili përcakton detyrat dhe detajet e mbështetjes që i ofrohet Komisionit. ECMI Kosova, megjithatë, NUK do të pranojë aplikacione nga aplikantët. Vetëm Sekretariati i Komisionit ose Zyrtari i autorizuar i Komunave të autorizuar kanë të drejtë të pranojnë aplikacione nga aplikantët.

Këtë Vendim mund ta gjeni në:



http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_81-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2016.pdf



MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT ME KOMUNAT E AUTORIZUARA

Në pajtim me Nenin 20 (Komunat e autorizuar), të Rregullores (QRK) - Nr.21/2015, me qëllim të përmirësimit të qasjes për dorëzimin e aplikacioneve, Komisioni ka lidhë memorandume mirëkuptimi me komuna të cilat janë të autorizuar nga Komisioni për të pranuar aplikacionet dhe kryer detyra të tjera të përcaktuara me memorandumet përkatëse.



KUSH KANË TË DREJTË TË APLIKOJNË PËR MARRJEN E CERTIFIKATAVE

Të gjithë shtetasit e Kosovës të cilët kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut, që nga viti 2001, kanë të drejtë aplikimi për marrjen e Certifikatave të vlefshmërisë se ka diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut.



CILI ËSHTË AFATI PËR APLIKIM

Lëshimi i certifikatave vlen brenda një viti nga fillimi dhe zyrtarizmi i punës së Komisionit. Zyrtarizmi i punës së Komisionit ka filluar me 5 maj 2016. Në këtë drejtim çdo shtetas i Kosovës ka të drejtë aplikimi deri me datën 5 maj 2017.



KU MUND TË GJENDEN FORMULARËT PËR APLIKIM

Formularët për aplikim janë pjesë e rregullores dhe mund të gjenden në:



[http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_\(QRK\)_-_NR__212015_PER_PROCEDURAT_DHE_KRITERET_PER_LESHIMIN_E_CERTIFIKATAVE_SHTETASVE_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_TE_CILET_KANE_MARR.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_(QRK)_-_NR__212015_PER_PROCEDURAT_DHE_KRITERET_PER_LESHIMIN_E_CERTIFIKATAVE_SHTETASVE_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_TE_CILET_KANE_MARR.pdf)

Formularët për aplikim, janë të publikuar edhe në: Ueb faqen e MASHT-it.



<http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/05/formular-per-aplikim-per-verifikimin-e-diplomave-te-leshuara-nga-universiteti-i-mitrovices-se-veriut.pdf>

Ueb faqen e Zyrës për Çështje të Komuniteteve:



[http://www.zck-ks.net/repository/docs/FORMULAR_P_R_AP-
LIKIM_P_R_VERIFIKIMIN_E_DIPLOMAVE_T__L_SHUARA_
NGA_UNIVERSITETI_I_MITROVIC_S_S__VERIUT.pdf](http://www.zck-ks.net/repository/docs/FORMULAR_P_R_AP-
LIKIM_P_R_VERIFIKIMIN_E_DIPLOMAVE_T__L_SHUARA_
NGA_UNIVERSITETI_I_MITROVIC_S_S__VERIUT.pdf)

Formularët për aplikim mund të merren edhe në Sekretarinë e Komisionit në Ndërtesën e MASHT:

Adresa: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
Rruga: Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, Kosovë,
si dhe tek zyrtaret përkatës të komunave.



CILA ËSHTË PROCEDURA E LËSHIMIT TË CERTIFIKATAVE

Procedura e lëshimit të certifikatave, zhvillohet si në vijim:

Aplikuesi duhet të plotësojë dhe nënshkruajë Formularin për aplikim, sipas Shtojcës 1 (një) të Rregullores.

Pas plotësimit të Formularit, aplikuesi duhet të përgatitë edhe dokumentet, si në vijim, që duhet të paraqiten për aplikim:

- 1.1. Kopje e letërnjoftimit;
- 1.2. Kopja e vërtetuar e diplomës origjinale;
- 1.3. Abstrakti i temës së diplomës (në rastet kur kërkohet një gjë e tillë);
- 1.4. Shtojca e diplomës ose kopja e vërtetuar e transkriptit/certifikatës së notave.



KU DUHET BËRË KËRKESA

Aplikuesi Formularin e plotësuar së bashku me dokumentacionin përkatës, e bënë kërkesën në Sekretariat të Komisionit apo përmes zyrtarit të autorizuar të komunës.

Adresa e Sekretariatit të Komisionit është si në vijim:

Sekretaria e Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, *Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Rruga: Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, Kosovë*, Zyrat e autorizuara të komunës.

Zyra e autorizuar në Komunën e autorizuar të Graçanicës
Zyra për arsim, kulturë, rini dhe sport Kati 3.
Aplikuesit mund të dorëzojnë aplikacionet çdo ditë pune prej 8:00h deri 16:00h.

Zyra e autorizuar në Komunën e autorizuar të Mitrovicës së Veriut
Administrata komunale Mitrovicë e Veriut
Rr. Lagja e Boshnjakëve pn
Mitrovicë e Veriut
Aplikuesit mund të dorëzojnë aplikacionet çdo ditë pune prej 9:00h deri 12:00h.

Zyra e autorizuar në Komunën e autorizuar të Ranillugut
Fshati Domoroc pn.
Zyra e Drejtorit për arsim, shëndetësi dhe politika sociale
Aplikuesit mund të dorëzojnë aplikacionet çdo ditë pune prej 8:00h deri 16:00h.



A KANË NEVOJË APLIKUESIT TË PARAQITEN PARA KOMISIONIT

Procedura para Komisionit zhvillohet pa pasur nevojë që personi të paraqitet fizikisht para Komisionit, përveç rasteve kur kërkohet një gjë e tillë nga ana e Komisionit dhe vlerësohet të jetë e domosdoshme për të kryer verifikimin.



KUSH ËSHTË PËRGJEGJËS PËR TË DHËNAT E PARAQITURA

Aplikuesi është përgjegjës për të gjitha të dhënat dhe dëshmitë e paraqitura. Originaliteti i dokumentacionit mbështetës do të verifikohet nga ana e Komisionit.



SI MERREN VENDIMET E KOMISIONIT

Pas shqyrtimit të aplikacionit Komisioni merr vendim për njohjen apo refuzimin e njohjes së diplomës, bazuar në kriteret si më poshtë:

- i. Forma e aplikacionit është kompletuar;
- ii. Dokumentacioni mbështetës është kompletuar;
- iii. Originaliteti i dokumentacionit mbështetës është verifikuar.

Në rast të një vendimi pozitiv, certifikata e vlefshmërisë do të lëshohet dhe dërgohet së bashku me vendimin.



KUR MERREN VENDIMET E KOMISIONIT

Vendimi i Komisionit merret brenda 30 ditësh pas dorëzimit të aplikimit.



KU MUND TE MERREN VENDIMET E KOMISIONIT

Vendimi i dërgohet palës në adresën apo tek personi sipas kërkesave të palës.



KUJT MUND T'I ANKOHENI

Në rast të një vendimi negativ, pala ka mundësin e rishqyrtimit të kërkesës dhe ka të drejtë që brenda 15 ditë pune të bëjë ankesë në vendimin e marrë nga ana e Komisionit.

Po ashtu, pala e pakënaqur, kundër Vendimit të Komisionit ka të drejtë ankese në Gjykatën kompetente brenda 15 ditë pune.



KU MBETET DOKUMENTACIONI I DËRGUAR PËR APLIKIM

Gjatë dhe pas përfundimit të punës i gjithë dokumentacioni administrohet nga Sekretaria e Komisionit dhe më pas i dorëzohen në Departamentin e Administratës dhe Buxhetit në MASHT-së për arkivim.



EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

ECMI Kosovo
Str. Nëna Terezë Nr.41, Apt.29
10000 Prishtinë/Priština, Kosovo
Tel. +381 (0) 38 224 473

Str. Kralja Petra 183a
38220 Mitrovica/ë North, Kosovo
+381 (0) 64 433 10 40

Email: info@ecmikosovo.org
Web: www.ecmikosovo.org